



**UNIVERSITETI**  
**I SHKENCAVE TË APLIKUARA**  
— FERIZAJ —

Kryesuesi i Këshillit Drejtues  
Prof. As. Dr. Samet Dalipi

Nr. Prot.: 786/21; Datë: 16.03.2021

Në bazë të nenit 22 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF), Këshilli Drejtues i UShAF në mbledhjen e mbajtur me datë 16.03.2021, mori

**V E N D I M**

- I. Miratohet Rregullorja mbi sjelljen e personelit akademik, jo-akademik, studentëve dhe punonjësve tjerë në UShAF.
- II. Rregullorja hynë në fuqi nga dita e miratimit të saj.

**A r s y e t i m**

Këshilli Drejtues i UShAF për qëllim të plotësimit të infrastrukturës ligjore në UShAF dhe harmonizimit të akteve të brendshme me Statutin e UShAF, pas elaborimit të draft rregullores në fjalë, në mënyrë unanime vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi i dorëzohet:

1. Këshillit Drejtues të UShAF;
2. Arkivit të UShAF;

Kryesuesi i Këshillit Drejtues  
Prof. As. Dr. Samet Dalipi



**UNIVERSITETI**  
**I SHKENCAVE TË APLIKUARA**  
— FERIZAJ —

Kryesuesi i Këshillit Drejtues  
Prof.As.Dr. Samet Dalipi

Nr.Prot.: 786/21; Datë:16.03.2021

Në bazë të nenit 22 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (UShAF),  
Këshilli Drejtues në mbledhjen e mbajtur më datën 16.03.2021 miratoi këtë

**RREGULLORE**  
**MBI SJELLJEN E PERSONELIT AKADEMIK,**  
**JO-AKADEMIK, STUDENTËVE DHE PUNONJËSVE TJERË NË**  
**UNIVERSITETIN E SHKENCAVE TË APLIKUARA NË FERIZAJ**

**Baza Ligjore**

Kjo rregullore është hartuar në pajtim me nenin 22 të Statutit të Universitetit të Shkencave të Aplikuara në Ferizaj (në tekstin e mëtejme: "Universiteti").

**Neni 1**

**Dispozitat e Përgjithshme**

- 1) Rregullorja përcakton dhe sqaron standardet e sjelljes për Stafin, studentët dhe punonjësit tjerë, në marrëdhëniet e tyre brenda Universitetit dhe midis Universitetit dhe komunitetit më të gjerë.
- 2) Kjo Rregullore miratohet me shumicën e votave të Këshillit Drejtues.

**Neni 2**

**Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregullore është të:

- mbështesë dhe promovojë marrëdhënie ndërnjerëzore;
- udhëheq me parimet e respektit të të drejtave themelore të njeriut;
- identifikojë dhe sqarojë sjelljet e pranueshme;
- përmbush misionin në arritjen e vlerave etike të punonjësve në Universitet.

**Neni 3**  
**Fushëveprimi**

Dispozitat e kësaj rregullore janë të obligueshme për të gjithë stafin e punësuar në Universitet, pavarësisht nga forma dhe lloji i kontratës së punës.

**Neni 4**  
**Rregullat, parimet dhe vlerat**

Kjo rregullore vë në zbatim parimet e përgjithshme të sjelljes etike, që rregullojnë: sjelljen dhe disiplinën që i përkasin marrëdhënies së punës në raport me kolegët dhe studentët.

**Neni 5**

Kjo rregullore përfshinë rregullat e parimeve të përgjithshme të sjelljes etike, të cilat i miraton Këshilli Drejtues i Universitetit.

**Neni 6**  
**Përgjegjësitë e Këshillit Drejtues**

Këshilli Drejtues i Universitetit në lidhje me këtë rregullore, ka këto përgjegjësi:

- a) Duhet të vendosin interesat e institucionit mbi interesat e tyre dhe nuk duhet të kërkojnë të përfitojnë nga pozicionet e tyre ndryshe nga sa parashikohet nga legjislacioni në fuqi;
- b) Të deklarohen për konflikt të interesit paraprakisht para ndërmarrjes së ndonjë veprimi administrativ;
- c) Nuk duhet të pranojnë asnjë mandat të veprorë, ose të përmbahet nga veprimi në një mënyrë të veçantë, nga organi që i ka caktuar ata, ose të pranojnë ndonjë udhëzim nga ndonjë individ, ose nga ndonjë parti politike, sindikatë, fetare ose burim tjetër i jashtëm;
- d) Nuk duhet të kërkojnë ose të pranojnë ndonjë mito ose konsideratë tjetër financiare, ose të kërkojnë ose të pranojnë ndonjë favor tjetër personal, i cili mund të ndikojë në to në procesin e vendimmarrjes;
- e) Menjëherë duhet të raportojë çdo përpjekje për mitdhënie apo mitmarrje ose të ofrojë favor personal te autoritetet përkatëse.

**Neni 7**  
**Menaxherët**

Kjo rregullore duke u nisur nga parimet e përgjithshme të sjelljes etike, përfshinë rregullat e sjelljes për menaxherët (Rektorin, Pro-Rektorët, Dekanët e Fakultetit, Drejtorët e Programeve, Sekretarin e Përgjithshëm).

**Neni 8**  
**Përgjegjësitë e menaxherëve**

Menaxherët e Universitetit, kanë këto përgjegjësi:

- a) Të vendosin interesat e institucionit mbi interesat e tyre, dhe të sillen konform përgjegjësiëve që parashihen nga kontrata e tyre e punës;
- b) Gjatë kryerjes së detyrës nuk duhet të ndikohen nga ndonjë kërkesë e cila nuk buron nga ligji mbi arsimin e lartë apo akteve të brendshme të Universitetit;
- c) Të deklarohen për konflikt të interesit paraprakisht para ndërmarrjes së ndonjë veprimi administrativ;
- d) Nuk duhet të lejojnë ofrim të mitos ose ndonjë favor tjetër, i cili mund të ndikojë në punën e tyre;
- e) Për çdo përpjekje për mitdhënie apo mitmarrje ose ndonjë favorit duhet të raportohet te mbikëqyrësi kompetent;
- f) Nuk duhet të keqpërdor burimet e institucionit, ose informacionin personal apo tregtar të mbajtur nga ai, për përfitime personale ose të ndonjë personi tjetër;
- g) Duhet të sigurojë që të gjithë personat nën autoritetin e tyre të jenë të informuar me rregullat përkatëse të kësaj rregullore.

**Neni 9**  
**Stafi Akademik**  
**Parimet etike**

Anëtarët e stafit akademik duhet të sillen në përputhje me parimet e përgjithshme të sjelljes etike në raport me:

- a) organin drejtues, menaxhimin dhe organet e tjera të institucionit,
- b) stafin tjetër akademik dhe ndihmës,
- c) studentët, dhe

- d) çdo person ose grup tjetër, që kanë një marrëdhënie kontraktuale ose marrëdhënie tjetër, ose interes në punë të institucionit.

#### **Neni 10**

#### **Të Drejtat e Stafit Akademik**

Stafi akademik ka të drejta profesionale, veçanërisht të drejtën për të vepruar në mënyra që e garantojnë pavarësinë dhe mjedisin për të mësuar në Universitet: dhe këto të drejta përfshinë:

- a) Lirinë akademike, deri te liria e shprehjes dhe liria e hulumtimit;
- b) Të vlerësohen si studiues dhe mësues në bazë të kriterëve intelektualë dhe profesionale dhe jo në pikëpamjet e tyre politike dhe fetare, apo çështje të tjera të preferencës personale;
- c) Të vlerësojë më mënyre objektive performancën dhe arritjet e studentëve sipas politikave të gradimit të Universitetit dhe kriterëve të paracaktuara të notimit;
- d) Të mos pranojë asnjë udhëzim për të vepruar ose të përmbahet nga veprimi në një mënyrë të veçantë nga ndonjë individ përveç një autoriteti më të lartë, ose nga ndonjë parti politike, sindikatë ose grup fetar, përveçse siç lejohet nga legjislacioni në fuqi;
- e) Të raportoj çdo mosrespektim të pretenduar të legjislacionit në fuqi ose parimeve etike tek autoriteti përkatës në besim pa pasoja personale negative.

#### **Neni 11**

#### **Përgjegjësitë e Stafit Akademik**

Personeli akademik i Universitetit, ka përgjegjësi:

- a) Të vendosin interesat e institucionit mbi interesat e tyre, dhe të sillen konform përgjegjësi që parashihen nga kontrata e tyre e punës;
- b) Gjatë kryerjes së detyrës nuk duhet të ndikohen nga ndonjë kërkesë e cila nuk buron nga ligji mbi arsimin e lartë apo akteve të brendshme të Universitetit;
- c) Të deklarohen për konflikt të interesit paraprakisht para ndërmarrjes së ndonjë veprimi administrativ;
- d) Nuk duhet të lejojnë ofrim ose pranim të mitos ose ndonjë favor tjetër, i cili mund të ndikojë në punën e tyre;
- e) Për çdo përpjekje për ofrim të mitos ose ndonjë favor duhet të raportohet te mbikëqyrësi kompetent;.

- f) Nuk duhet të keqpërdor burimet e institucionit, ose informacionin personal apo tregtar të mbajtur nga ai, për përfitime personale ose të ndonjë personi tjetër;
- g) Të mos keqpërdorin burimet e institucionit, ose informacionin personal ose financiar të mbajtur prej tij, përfshirë pronësinë intelektuale, për përfitime personale ose të ndonjë personi ose grupi tjetër;
- h) Të sillen sipas parimeve të përgjithshme të sjelljes etike kur marrin pjesë në emërim, promovim ose komisione të tjera që prekin personelin akademik dhe kur marrin pjesë në komisione ose organe të tjera të interesuara për pranimin, vlerësimin, provimin dhe veprime të tjera që kanë të bëjnë me studentët dhe në aktivitete individuale dhe grupore me studentë;
- i) Të respektojnë studentët e universitetit dhe të shmangë çdo shfrytëzim ose ngacmim, apo trajtim diskriminues të studentëve;
- j) Të respektojnë diversitetin e studentëve, përfshirë, por pa u kufizuar në, besimet e tyre politike dhe fetare;
- k) Të mbrojnë lirinë akademike të studentëve;
- l) Të mos përfshihen në plagjiaturë, të mos përmendin ose të atribuojnë punën e të tjerëve, të falsifikojnë rezultatet dhe të respektojnë parimet etike në lidhje me mbrojtjen e të dhënave personale, dhe parimeve të tjera specifike në fushat e përcaktuara, sipas rregullave të institucionit (për shembull në shkencë dhe kërkimet sociologjike) kur marrin pjesë në aktivitete kërkimore;
- m) Të mos diskriminojnë ose ngacmojnë kolegët dhe të respektojnë shumëllojshmërinë e mendimeve dhe shprehjes së lirë;

## **Neni 12**

### **Stafi Administrativ (jo-akademik)**

Anëtarët e stafit administrativ duhet të sillen në përputhje me parimet e përgjithshme të sjelljes etike të nënvizuara në rregulloren e sjelljes dhe këto parime duhet të zbatohen nga stafi administrativ. Këto rregulla përfshinë parime të sjelljes dhe parashikojnë sanksione për mosrespektim në përputhje me legjislacionin në fuqi.

## **Neni 13**

### **Përgjegjësitë e Stafit Administrativ**

Stafi Administrativ i Universitetit, ka këto përgjegjësi:

S.D.

- a) Të vendosin interesat e institucionit mbi interesat e tyre
- b) Duhet të sigurojnë ruajtjen e normave etike institucionale brenda njësisë që drejtojnë.
- c) Të mos diskriminojnë ose ngacmojnë kolegët dhe të respektojnë shumëllojshmërinë e mendimeve dhe shprehjes së lirë;
- d) Të deklarohen për konflikt të interesit paraprakisht para ndërmarrjes së ndonjë veprimi administrativ;
- e) Nuk duhet të lejojnë ofrim të mitos ose ndonjë favor tjetër, i cili mund të ndikojë në punën e tyre;
- f) Të mos keqpërdorin burimet e institucionit, ose informacionin personal apo financiar të mbajtur prej tij, përfshirë pronësinë intelektuale, për përfitime personale ose të ndonjë personi ose grupi tjetër;
- g) Të raportojnë tek eprori në rastet kur kanë konstatuar parregullsi ose akte jo-etike dhe të ruajnë e të mos fshehin evidencat që i vërtetojnë ato.
- h) Të respektojnë organet drejtuese, kolegët dhe personelin akademik.
- i) Të respektojnë studentët dhe të ruajnë një sjellje korrekte kundrejt tyre, në përputhje me rregullat etike e morale, pa cenuar dinjitetin personal të ndonjë individi.

#### **Neni 14**

#### **Sjelljet e papranueshme**

Sjelljet e papranueshme (në kundërshtim me këtë rregullore) sanksionohen konform rregulloreve në fuqi në Universitet.

#### **Neni 15**

#### **Sjelljet e papranueshme te stafit akademik në raport me studentët**

1. Ushtrimi i përgjegjësisë akademike (mësimore, vlerësuese apo mbikëqyrëse) për çdo student, me të cilin anëtari i stafit është në konflikt interesi.
2. Vendosja e kushteve për përmbushjen e kërkesave të mësimin, kalimi i provimeve duke u kërkuar studentëve që ta blejnë literaturën e caktuar apo mjete të tjera mësimore, ose duke u kërkuar favore politike, seksuale, financiare, ose të tjera me peshë;
3. Diskriminimi, duke përfshirë ngacmimet kundër një studenti në baza politike ose për shkak të racës, ngjyrës, fesë, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, origjinës etnike, origjinës kombëtare, prejardhjes, statusit martesor, shtatzënisë, paaftësisë fizike apo mendore;

4. Përdorimi i pozitës apo i kompetencave nga anëtari i stafit për të detyruar gjykimin apo vetëdijen e një studenti ose për t'i shkaktuar dëm një studenti për arsye arbitrare ose personale.

#### **Neni 16**

##### **Sjelljet e papranueshme të stafit akademik në raport me Kolegët**

1. Vlerësimet e kompetencave profesionale të stafit tjetër akademik ose të kandidateve nën konsideratë për punësim, me kritere që nuk e reflektojnë drejtpërdrejtë sjelljen profesionale, duke përfshirë edhe përmbajtjen nga kritikë, për shkak të interesave personale apo kritikës së punës së të tjerëve për arsye personale.
2. Diskriminimi, duke përfshirë ngacmimet kundër kolegut në baza politike ose për shkak të racës, ngjyrave, fesë, gjinisë, orientimit seksual, identitetit gjinor, origjinës etnike, origjinës kombëtare, prejardhjes, statusit martesor, shtatzënisë, paaftësisë fizike apo mendore.
3. Shkelja e rregullave të përcaktuara që e rregullojnë konfidencialitetin në procedurat personelit.

#### **Neni 17**

##### **Sjelljet e papranueshme në raport me Universitetin**

1. Përdorimi i paautorizuar i burimeve të Universitetit ose objekteve në një shkallë të konsiderueshme për qëllime personale, komerciale, politike apo fetare.
2. Kërcënimet për lëndime fizike apo ngacmimi ndaj një anëtari tjetër të komunitetit të Universitetit, që e pengojnë punën dhe aktivitetet universitare të atij personi. Këtu përfshihet lobimi, shantazhi, zhvatja, mitoja dhe korrupsioni, si dhe forma të tjera të veprave të pandershme, që i shkelin standardet e profesionit akademik.
3. Diskriminimi, duke përfshirë ngacmimet kundër punëtorëve të Universitetit në baza politike ose për shkak të racës, ngjyrës, fesë, gjinisë, orientimit seksual, origjinës etnike, prejardhjes, statusit martesor, shtatzënisë, paaftësisë fizike apo mendore.
4. Shkelje serioze të politikave të Universitetit, që e rregullojnë sjelljen profesionale të stafit akademik, duke përfshirë, por jo kufizuar, politikën që aplikohen për hulumtimin shkencor, aktivitetet profesionale të jashtme, konfliktet e përkushtimit, praktikën klinike apo dhunën në vendin e punës.



## Neni 18

### Puna kërkimore-shkencore

Shkelja e standardeve të ndershmërisë intelektuale, dhe keqpërdorimi i qëllimshëm i shkrimeve, hulumtimeve dhe gjetjeve të tjerëve, plagjiaturën bie ndesh me dispozitat e kësaj rregullore.

## Neni 19

### Të drejtat e studentëve

Studentët, kanë të drejtë:

- a) Çdo student ka të drejtën të jetë i mbrojtur nga diskriminimi racor, fetar, etnik, përkatësia politike, mosha, gjinia dhe aftësitë e kufizuara.
- b) Studentët kanë të drejtën e lirisë së shprehjes, të mbledhjes dhe grupimeve për aq sa shfrytëzimi i këtyre lirive pajtohet me politikat e universitetit, derisa nuk ndërhyt në funksionimin normal të programeve të studimit dhe respekton të drejtat e tjerëve.
- c) Studentët janë të lirë të organizojnë dhe marrin pjesë në organizata studentore, në përputhje me legjislacionin në fuqi, për të promovuar interesin e tyre të përbashkët brenda universitetit.
- d) Organizatat studentore janë të lira të shqyrtojnë dhe diskutojnë të gjitha çështjet e interesit, në zbatim me rregulloren e Universitetit. Organizatat e njohura dhe të pranuara mund të gëzojnë privilegjin të përdorin godinat, lehtësirat dhe shërbimet e Universitetit sipas politikave dhe procedurave administrative të Universitetit.
- e) Studentët kanë të drejtën të jenë të lirë nga çdo lloj ngacmimi nga anëtarët e komunitetit të Universitetit. Studentët kanë të drejtën dhe përgjegjësinë të raportojnë, në mirëbesim dhe pa frikë hakmarrjeje, çdo shkelje të kësaj rregullore apo politike të Universitetit tek Këshilli i Etikës, drejtuesit akademikë apo administrativë të Universitetit.

## Neni 20

### Përgjegjësitë e studentëve

Studentët në ambientet e Universitetit, kanë këto përgjegjësi:

- a) Të zbatojnë orarin e mësimi dhe t'u përmbahen rregullave të sanksionuara në Statutin dhe në Rregulloren e Universitetit.

- b) Të paraqiten në mënyrë serioze në mjediset e institucionit, që përfshinë një veshje të përshtatshme dhe dinjitoze, si dhe përdorimin e një fjalori në përputhje me normat e etikës së komunikimit dhe sjelljes qytetare.
- c) Të respektojnë personelin akademik, ndihmës akademik dhe personelin administrativ, shokët dhe rregullat e mësimit. T'u drejtohen personelit akademik dhe atij administrativ me titujt akademikë përkatës.
- d) Të mos kryejnë veprime dhe gjeste provokuese apo ngacmuese ndaj personelit akademik apo studentëve të tjerë në mjediset e institucionit.
- e) Të mos ofrojnë në asnjë formë privilegje, përfitime, ndërhyrje, favorizime, pagesa apo dhurime, vetë apo nëpërmjet personave të tjerë, me qëllim marrjen e rezultateve të larta, apo favorizime të tjera, të cilat anëtarë të personelit të Universitetit mund t'i kryejnë për shkak të detyrës.
- f) Të mos kopjojnë, të mos kryejnë akte që dëmtojnë procesin mësimor si dhe të mos shmangen nga shlyerja e detyrimeve akademike.
- g) Të mos konsumojnë pije alkoolike apo duhan në mjediset e brendshme të institucionit.
- h) Të mos përdorin celular dhe t'a mbajnë atë të fikur gjatë orarit të mësimit ose provimit në auditor, me përjashtim të rasteve kur nevojitet për qëllime didaktike.
- i) Studenti, i cili përfshihet në një veprim të ndaluar apo thyerje ligji, i cili rezulton në prishjen e orës së mësimit, mund të drejtohet nga pedagogu të lëshoj sallën për periudhën e mbetur të orës së mësimit. Për përjashtime më të gjata si pasojë e prishjes së orës së mësimit duhet të merren vendime me shkrim nga organet përkatëse.

## Neni 21

### Sjelljet e ndaluara të studentëve

Sjelljet e ndaluara përfshijnë, por nuk janë të kufizuara në sa më poshtë:

- a) Ndërhyrje apo përçarje që pengon dhe dëmton misionin e Universitetit, proceset ose funksionet që shkelin të drejtat e të tjerëve. Veprat të kundërligjshme përfshirë këtu : bllokimi i çfarëdo pjese të ndërtesës së Universitetit, pa autorizimin e autoriteteve menaxheriale të Universitetit; bllokimi i hyrjes apo daljes së ndonjë pjese të ndërtesës së Universitetit; vendosjen e zjarrit ose me ndonjë mjet tjetër, duke dëmtuar ndërtesën, pronën apo pasurinë universitare.

- b) Përdorimi, apo shpërndarja e substancave narkotike ose të rrezikshme, me përjashtim kur lejohet shprehimisht me ligj. Universiteti ndalon mbajtjen, përdorimin, shitjen ose shpërndarjen e substancave të paligjshme apo substancave të pakontrolluara.
- c) Sjellja jo e rregullt, abuzive, e dhunshme ose shprehje tepër e zhurmshme, çdo përpjekje apo kërcënim i paramenduar me synimin lëndimin e personit tjetër, së bashku me aftësinë e dukshme për ta bërë këtë, është e ndaluar.
- d) Kërcënimi apo ushtrimi i dhunës fizike.
- e) Pengimi i një anëtari të personelit akademik dhe administrativ për të përmbushur detyrat dhe funksionet e tij të përcaktuara në aktet e brendshme, apo edhe në dispozitat ligjore në fuqi.
- f) Falsifikimi ose manipulimi i shkresave dhe dokumenteve zyrtare të Universitetit, përdorimi i dokumenteve dhe të dhënave zyrtare të Universitetit për qëllime keqinterpretimi. Përdorimi i telekomunikacionit, rrjetit të të dhënave ose ndonjë pajisjeje elektronike në pronësi dhe administrim të Universitetit për qëllime të paligjshme/të pahijshme, në shkelje të rregullores, politikave të Universitetit ose ligjeve, është e ndaluar.
- g) Çdo veprim i ndërmarrë apo situatë e krijuar, me dashje ose nga pakujdesia, duke krijuar probleme në mbarëvajtjen e veprimtarive të Universitetit. Këto veprime përfshijnë, por nuk kufizohen në:
- kopjimin e përgjigjeve nga një student tjetër gjatë provimit;
  - komunikimin e paautorizuar me të tjerët gjatë një provimi;
  - lejimin e një studenti tjetër të kopjojë përgjigjet;
  - zëvendësimin e një personi tjetër ose përdorimin e një tjetri si zëvendësues gjatë një provimi;
  - programimin paraprak të një makine llogaritëse apo pajisjeve të tjera elektronike që mbajnë përgjigje ose informacion të paautorizuar për provim;
  - përdorimin e materialeve të paautorizuara, përgjigjeve të parapërgatitura, shënimeve të shkruara apo informacionit të fshehur gjatë një provimi;
  - lejimin e të tjerëve të bëjnë për ta një detyrë apo pjesën e një detyre (psh. detyrën e grupit), përfshirë përdorimin e shërbimit komercial të punimeve (blerjen e tyre);
  - ofrimin ose dhënien e mitos personelit të Universitetit ose atyre që mbajnë pozicione drejtuese;
  - mospagimin e detyrimeve financiare ndaj Universitetit.
  - përvetësimin e paautorizuar të aseteve ose shërbimeve brenda Universitetit.

- mbajtjen pa leje të armëve të zjarrit ose armëve të flohta (armë të modeleve dhe llojeve të ndryshme, mjete shpërthyes, lëndë plasëse, thikat etj.) që përbëjnë rrezik për mirëqenien e anëtarëve të komunitetit universitar.
  - zotërimin, përdorimin, ruajtjen ose transportimin e armëve të zjarrit, eksplozivit, fishekzjarrëve apo kimikateve të rrezikshme, përjashtuar mjetet apo lëndët për të cilat ekziston autorizimi për përdorim në klasë.
- h) Prishja, dëmtimi ose shkatërrimi i pronës publike ose private. Hyrja ose përdorimi i objekteve pronë e Universitetit, për një qëllim të pahijshëm, pa autorizimin e duhur ose duke ndihmuar të tjerët të veprojnë kështu.
- i) Ngacmime të çdo lloji ndaj personelit ose studentëve të Universitetit. Angazhimi i një sjelljeje në formë verbale, elektronike, vizuale, të shkruar ose trupore (fizike) ndaj një individi apo grupi individësh që ka të ngjarë të provokojë/rezultojë në një reagim negativ, dëmtues dhe në një stres mendor apo emocional.

#### **Neni 22**

##### **Denoncimi i shkeljeve**

Secili person ka të drejtë të raportojë, shkelje të dispozitave të kësaj rregullore, përpara anëtarëve të Këshillit të Etikës, udhëheqësit të njësisë akademike apo Rektorit. Secili denoncim duhet të procedohet te Këshilli i Etikës.

#### **Neni 23**

##### **Masat dhe Sanksionet Disiplinore**

Masat disiplinore duhet të bazohen në parimet e drejtësisë, konfidencialitetin dhe njoftimit në kohë. Çështjet tjera rreth shqiptimit të masave janë të rregulluara me aktet e brendshme të Universitetit.

#### **Neni 24**

##### **Komisioni Disiplinor**

Komisioni Disiplinor është përgjegjës për zhvillimin e procedurave disiplinore që shoqërojnë këtë rregullore të sjelljes, dhe propozon sanksionet për shkeljet e kësaj rregullore konform rregullores për masat dhe procedurën disiplinore.

## Neni 25

### Ankesa

Stafi dhe studentët kanë të drejtë të apelojnë vendimin e njësisë së mandatuar për përcaktimin e masës disiplinore sipas akteve të brendshme të Universitetit.

## Neni 26

### Dispozitat përfundimtare

1. Për çështjet që nuk janë paraparë me këtë Rregullore vlejnë dispozitat e ligjeve në fuqi.
2. Kjo rregullore hyn në fuqi nga dita e miratimit nga Këshilli Drejtues i Universitetit.
3. Ndryshimi dhe plotësimi i kësaj Rregullore bëhet sipas të njejtës procedurë të miratimit.
4. Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregullore shfuqizohet Rregullorja mbi sjelljen e personelit akademik, jo-akademik, studentëve dhe punonjësve tjerë në UShAF nr. 4653/19 e datës 27.12.2019.

Kryesuesi i Këshillit Drejtues

Prof.As.Dr. Samet Dalipi

